




REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA
KOMUNA E SUHAREKËS
OPSTINE SUVA REKA
MUNICIPALITY -SUHAREKE



REPUBLIKA E KOSOVËS - KOSOVA
REPUBLIKA KOSOVA - KOSOVO
REPUBLIC OF KOSOVA - THE MUNICIPALITY OF SUHAREKA



MARRE NË DORËZIM		PRIMALJEN RECEIVED	
Org. Jeshkica Org. Unit	Numri Noj Number	Shifra Prag Appendix	Vlera Vrednost Value
	01	016	18052 £

Datë: 19.05.2020

Në bazë të vendimit 01-Nr-463-18645 të datës 28.04.2017 të Asamblesë Komunale dhe në bazë të Vendimit për ndryshim –plotësimin e vendimit 01-Nr-463-18645 të datës 28.04.2017, në bazë të vendimit të Asamblesë Komunale për formimin e komisionit 01-Nr-016-41940 të datës 28.06.2019, në bazë të procesverbalit nr. 39/2020 të komisionit për zbatimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës të date 19.05.2020, në bazë të Ligjit për dhënien në shfrytëzim dhe këmbim të pronës së paluejtshme të Komunës Ligji Nr. 06/L-092 ,komisoni përkatës vendosi njëzëri të shpall:

KONKURIM TË HAPUR Nr.02/2020

Për dhënien në shfrytëzim afatgjatë prej 15 (pesëmbëdhjetë) deri 99 (nëntëdhjetë e nëntë) vite të pronës së paluajtshme komunale:

1. Parcelat kadastrale:

P-72116046-01165-5, me sipërfaqe të përgjithshme prej; 1928m², sipas çertifikatës së pronës nr.952-2/2017-2221 datës 04.04.2017, zona kadastrale Suharekë, vendi I quajtur “ POJATA/Siloxha”, e evidentuar pasuri shoqërore në emër të Kuvendit Komunal –Suharekë.
Nga sipërfaqja e përgjithshme e cekur më lartë ndahen 1490m², për ndërtimin e objektit afarist banesorë, me destinim sipas planit zhvillimorë komunalë ndërtim.

Dëshmitë e kërkuara:

1. Kopja e dokumentit të identifikimit për personat fizik dhe juridik.
2. Çertifikata e regjistrimit të biznesit/OJQ-së (për personat juridik).
3. Dëshmi për kryerjen e obligimeve komunale (për personat fizik – Tatimi në pronë ; për personat juridik – Taksa Komunale dhe tatimi në pronë.
4. Dëshmi për obligimet e kryera ndaj ATK- së (për personat juridik).
5. Deklaratë vjetore tatimore nga ATK –ja (Formular vjetor tatimorë për dy vitet e fundit) –për personat juridik.
6. Garancioni bankar nga banka ose kompanitë e sigurimeve të licencuara në Kosovë në 10% të vlerës së investimeve i cili duhet të sillet para nënshkrimit të kontratës.

Kriteret e kërkuara;

-Oferta ekonomkisht më e favorshme.

- Dëshmi për mundësi të realizimit të projektit si: qarkullimi bankar për dy vitet e fundit, marrëveshje me ndonjërin nga bankat komerciale në Kosovë, apo marrëveshje të noterizuar (konsercium) me operatorë ekonomik - **10% të pikëve.**

- Poseduesi i njesisë kadastrale në bazë të të drejtave të tij pronësore-juridike i takojnë jo më pak se **20%. e ndërtimit NETO (Banesa dhe lokale afariste) - 50% të pikëve.**

- Plani dinamik- jo më shumë se 2 vite - **10% të pikëve.**

- Veprimtaria adekuate - **10% të pikëve.**



- Personat fizik apo juridik që posedojnë parcela në pronësi brenda bllokut ndërtimor përfitojnë **10% të pikëve.**
- Projekti Ideor- konceptual konform Planit Zhvillimor Urban - **10% të pikëve**

Vërejtje:

- Aplikimi me mungesë të ndonjërit prej dokumenteve do të thotë diskualifikim.
- Aplikimi nën normat minimale të definuara do të thotë diskualifikim.
- Veprimtaria jo adekuate do të diskualifikohet nga konkurimi.
- Kushtet dhe Leja Ndërtimore për parcelat në fjalë definohe për komplet bllokun ndërtimor.
- Kushtet ndërtimore dhe Leja ndërtimore definohe nga Drejtoria për Urbanizëm dhe Planifikim konform Planit Zhvillimor Urban dhe dispozitat e tjera ligjore.
- Kushtet themelore janë:
 - Destinimi: Zonë qendrore banimi,
 - Etazhiteti minimal - 4 etazhe mbi nivelin e tokës,
 - Indeksi i shfrytëzimit të shputës së ndërtimit – min. 35%.

(Për informata më të hollësishme rreth kushteve të ndërtimit, drejtoheni pranë DUP)

- Para paisjes me leje ndërtimi, duhet të definohe banesat dhe lokalet të cilat do ti kompenzohen Komunës së Suharekës.

Afati për tërheqjen e formularit të ofertave është nga dita e publikimit deri më datë 29.05.2020, zyra pritëse te gjendja civile, Komuna Suharekë.

Afati i dorëzimit të ofertave më datë 02.06.2020 deri në ora 13:30 zyra pritëse te gjendja civile, Komuna Suharekë.

Hapja e ofertave bëhet me 02.06.2020 në ora 14:00 në sallën e bordit në Komunën e Suharekës.

Hapjen dhe vlerësimin e ofertave e bën komisioni përkatës i kuvendit të Komunës së Suharekës dhe përfituesin e vendos Asambleja Komunale konform ligjit nr.06/L-092.

Informatat shtesë;

Nr. tel: 029 271 708

emrush.bytyci@rks-gov.net



Kryesuesi i komisionit:

Emrush BYTYCI

